



RAYS

Reconnecting Albanian Youth and Society

RRËFIMI MUZIKOR UDHËZUES HAP PAS HAPI PËR PROFESIONISTËT





Ky udhëzues është hartuar nga Dr. Jade Levell

Ky udhëzues është hartuar për të shoqëruar trajnimin e organizuar si pjesë e Projektit RAYS në 2022-2023. RAYS është një program pilot në mbështetje të të rinjve shqiptarë dhe punon me ta, me komunitetet e tyre dhe institucionet përkatëse për të krijuar partneritete të qëndrueshme, për të kuptuar më mirë motivet që i shtynjë të rinjtë drejt përfshirjes në krime të rënda dhe të organizuara, për të shkatërruar përfundimisht ndikimin e grupeve kriminale, dhe për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse.

Në këtë udhëzues ofrohen udhëzime hap pas hapi për praktikantë për format e elicimit muzikor si një mjet për të dëgjuar dhe për t'u angazhuar me të rinjtë e cenueshëm dhe të marginalizuar.

Shënim: Ky dokument u hartua me mbështetjen e projektit Rilidhja e Rinisë dhe Shoqërisë Shqiptare (RAYS). Opinionet e shprehura janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht shprehin pikpamjet e projektit dhe Qeverisë Britanike.


PËRMBAJTJA

1. HYRJE NË RRËFIMIN MUZIKOR	4
1.1. Rrëfimi muzikor si mjet dëgjimi	5
1.2. Rrëfimi muzikor si instrument për të identifikuar përvojat negative të fëmijërisë (PNF)	6
1.3. Rrëfimi muzikor si mjet që të rinjtë ta ndjejnë se dëgjohen dhe merren në konsideratë	8
2. Ç'JHONË KA KRIJUAR RRËFIMI MUZIKOR NË KONTEKSTIN SHQIPTAR?	12
3. PËR KË VLEN KY UDHËZUES?	13
4. NGA T'IA FILLOJMË ME RRËFIMIN MUZIKOR?	14
4.1. Hapi 1: Krijimi i një mjedisi mirëbesimi	15
4.2. Hapi 2: Përgatituni për fazën e intervistës	20
4.3. Hapi 3: Zgjidhni një temë për seancat e intervistës	25

1. HYRJE NË RRËFIMIN MUZIKOR

Muzika shoqëron çdo njeri gjatë gjithë jetës së tij/saj dhe shpeshherë lidhet me momente të rëndësishme të jetës. Ajo ndihmon në përçimin e ndjenjave dhe kujtimeve të veçanta të atij momenti të veçantë. Le të mendojmë për një çast:

Muzika mund të jetë një formë e fuqishme për të sjellë kujtime (pozitive



e negative) dhe mund të bashkojë breza të ndryshme, sepse, edhe nëse zhanret dhe shijet e muzikës janë të ndryshme, të gjithë kemi një vlerësim për muzikën, në një formë apo një tjetër. Përdorimi i muzikës si një formë për të dëgjuar na bën të mundur ta përdorim këtë vlerësim të përbashkët të muzikës si një mjet për të komunikuar me njerëzit.

Hulumtimet e mëparshme që janë marrë me rrëfimin muzikor kanë konstatuar se muzika është një mjet i fuqishëm për të komunikuar me grupet e cenueshme ose të marginalizuara në shoqëri. Përdorimi i muzikës mund të jetë një formë alternative ndaj pyetjeve të drejtpërdrejta që bëhen në lidhje me sfidat dhe vështirësitë që ka përjetuar një person. Muzika ia krijon mundësinë pjesëmarrësit që ta kontrollojë në hapësirën e intervistës dhe ta vendosë vetë se sa, shumë apo pak nga vetja, dëshiron të ndajë me të tjerët. Kjo qasje mund të funksionojë edhe pse duket se bie në kundërshtim me intuitën, por kemi konstatuar në hulumtimin tonë, si në Britaninë e Madhe, ashtu edhe në Shqipëri¹ se, sa më pak pyetje të bëhen, aq më shumë njerëzit inkurajohen të hapen, të besojnë dhe të ndajnë më shumë nga vetja e tyre. Muzika mund të krijojë një urë mirëkuptimi mes njerëzve që kanë përvoja shumë të ndryshme në jetë dhe mund të bëhet mbështetje për krijimin e një hapësire bashkëpunimi dhe të hapur për të dëgjuar me vëmendje.

1.1. RRËFIMI MUZIKOR SI MJET DËGJIMI

Përfitimet e rrëfimit muzikor

▶▶ Muzika si spirancë për kujtimet

Muzika është përdorur shpesh si mekanizëm i vetë individit për të përballuar vështirësitë dhe mund të rithirret gjatë intervistës, duke vepruar si spirancë për kujtesën.

▶▶ Tekstet dhe videoklipet muzikore si instrumente komunikimi

Si tekstet e këngëve, ashtu edhe videoklipet e tyre muzikore mund të përdoren si instrumente për komunikim nga pjesëmarrësit, duke i përdorur ato si metafora apo si ilustrime të së kaluarës. Në hulumtimin tonë në Shqipëri konstatuam se disa njerëz përdorin këngë në gjuhë të ndryshme për të evidentuar përvojat ose dëshirat e tyre për udhëtime jashtë vendit.

1 Levell, J. (2022) PROGRAMI POLIT PËR ELICITIMIN MUZZKOR: Raport me gjetje nga trajnimi dhe pilotimi i Elicitimit Muzikor nga Projekti RAYS me të rinjtë e kriminalizuar në Shqipëri: RAYS: Rilidhja e të rinjve shqiptarë me shoqërinë shqiptare. RAYS: Palladium

Levell, J. (2019) "Këto ishin këngët që më ringritën; askush nuk ma kishte bërë këtë pyetje më parë": Elicitimi muzikor me burra që dikur ishin përfshirë në banda për përvojat e tyre të dhunës dhe abuzimit në familje në fëmijëri, në: International Journal of Qualitative Methods. 18. Gjetendet në internet në adresën: <https://journals.sagepub.com/doi/10.1177/1609406919852010>



» Muzika si instrument rrëfimi

Muzika është përdorur si një mjet rrëfimi nga pjesëmarrësit për të strukturuar dhe për t'i dhënë ritëm dhe duke u dhënë atyre një kontroll më të madh në hapësirën e intervistave. Disa pjesëmarrës mund të përdorin pikërisht muzikën si mjet rrëfimi në intervistë, për të evidentuar një “kapitull” të ndryshëm në rrëfimet e tyre të historisë së jetës. Ajo mund të funksionojë edhe si pauzë pushimi përpara se të kalohet në temën tjetër. Kjo u jep pjesëmarrësve kontroll më të madh të hapësirës së intervistës si dhe mundësinë për të planifikuar paraprakisht përgjigjet e tyre.

» Muzika mund të ndërtojë ura mirëkuptimi

Dëgjimi i muzikës me të tjerë mund të kthehet në një përvojë të fuqishme që i bashkon njerëzit. Ajo krijon një terren të përbashkët dhe i vendos pjesëmarrësin në pozicionin e kuratorit, mikpritësit dhe ekspertit në sallë.

1.2. RRËFIMI MUZIKOR SI INSTRUMENT PËR TË IDENTIFIKUAR PËRVOJAT NEGATIVE TË FËMIJËRISË (PNF)

Për të identifikuar sfidat me të cilat përballen të rinjtë, mund të jetë e dobishme të identifikohen përvojat e ndryshme negative të fëmijërisë (PNF) që kanë përjetuar. Koncepti i PNF-ve u zhvillua në një studim të madh të kryer me mbi 17,000 njerëz në SHBA. Studiuesit konstatuan se katër apo më shumë përvoja negative në fëmijërisë krijojnë një ndikim të konsiderueshëm afatgjatë në shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve gjatë gjithë jetës së tyre. Për të punuar me PNF-të, hapi i parë është identifikimi i tyre. Rrëfimi muzikor mund të përdoret si instrument që ndihmon në identifikimin më të lehtë të PNF-ve. Në hulumtimin tonë të mëparshëm në Shqipëri, pjesëmarrësit na treguan një sërë përvojash negative që kishin përjetuar në fëmijëri dhe që kishin ndikuar në jetën e tyre si dhe në ndjesinë e të qenit të rëndësishëm për shoqërinë. Rrëfimi muzikor mund të përdoret si mjet për të identifikuar përvojat negative të fëmijërisë, ku përfshihen të gjitha ngjarjet e dhimbshme që kanë ndodhur në fëmijëri.



Përvojat negative të fëmijërisë janë, por nuk kufizohen vetëm me to:

Abuzimi

- » Abuzimi emocional
- » Abuzimi fizik
- » Abuzimi seksual

Vështirësitë në familje

- » Dhuna në familje dhe abuzimi
- » Abuzimi me substancat në familje
- » Sëmundje mendore në familje
- » Ndarja ose divorci i prindërve
- » Anëtar i familjes i përfshirë në krime

Neglizhenca

- » Neglizhenca emocionale
- » Neglizhenca fizike

Pse duhen shqyrtuar PNF-të?

Identifikimi i PNF-ve është i rëndësishëm në kontekstin e gjerë të trajtimit të pabarazive në shoqëri. Është vërtetuar se PNF-të kanë ndikim afatgjatë në shëndetin dhe sjelljen e individëve, lidhen me të gjithë sektorët dhe e përfshijnë të gjithë shoqërinë. Të gjithë kemi për të bërë pjesën tonë për parandalimin e përvojave negative dhe për rritjen e ndërgjegjësimit për PNF-të.



Hulumtimet tregojnë se, krahasuar me njerëzit që nuk kanë pasur PNF, ata me katër apo më shumë përvoja negative në fëmijëri kanë më shumë të ngjarë:

1. Të kenë qenë në burg
2. Të kenë kaluar sëmundje kardiake (të zemrës)
3. Të kenë bërë vizita të shpeshta te mjeku
4. Të kenë kryer akte të dhunshme në 12 muajt e fundit
5. Të kenë pasur sjellje që dëmton shëndetin (p.sh., abuzim me pijet alkoolike, duhanpirje, përdorim droge, etj.)

Përvojat negative dhe të dhimbshme që kanë kaluar fëmijët mund të ndikojnë për një kohë të gjatë në aftësinë e tyre për të menduar, ndërvepruar me të tjerët dhe për të mësuar.

PNF-të nuk duhet të shihen si fati i dikujt. Ka shumë gjëra që mund të bëhen për të ofruar shpresë dhe për të ndërtuar qëndresë tek fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit që kanë përjetuar ngjarje negative në fazat e hershme të jetës. Hulumtimet kanë evidentuar se marrëdhëniet me një të rritur të besuar gjatë fëmijërisë mund të zbusin ndikimet e PNF-ve në mirëqenien mendore dhe fizike të fëmijës.

1.3. RRËFIMI MUZIKOR SI MJET QË TË RINJTË TA NDJEJNË SE DËGJOHEN DHE MERREN NË KONSIDERATË

Me përdorimin e muzikës së mjet për të dëgjuar, në synojmë:

- ▶▶ Të krijojmë një mjedis bashkëpunimi
- ▶▶ Të ofrojmë hapësirë ku të rinjve iu dëgjohej fjala
- ▶▶ Të dëgjojmë aktivisht dhe me vëmendje atë që duan të tregojnë të rinjtë
- ▶▶ T'u bëjmë të mundur të vendosin sa, shumë apo pak, duan të tregojnë nga vetja e tyre.

Duke dëgjuar për zgjedhjet e tyre muzikore dhe duke u angazhuar me muzikën që ata pëlqejnë bëhet e mundur që disbalancat e pushtetit mes bashkëbiseduesit/punonjësit dhe të rinjve të zhvendosen.

Kështu, synojmë t'u japim të rinjve ndjesinë se ata *kanë rëndësi për ne*.



Duke shqyrtuar se si e perceptojnë të rinjtë të qenit “të rëndësishëm” (ose jo) na krijon mundësinë të kuptojmë më mirë se si ndikojnë në ndjenjën e të rinjve për vendin që zënë në këtë botë përvojat me trauma dhe marginalizimi. Krijimi dhe prodhimi i muzikës janë një mënyrë që të rinjtë të zhvillojnë në mënyrë organike një hapësirë në të cilën ata ndjehen se kanë ‘rëndësi’.

Elementët e ndjesisë se je i rëndësishëm për të tjerë²

Ndërgjegjësimi	Rëndësia	Mbështetja
Jam dikush që njerëzit e tjerë i kushtojnë vëmendje.	Jam dikush për të cilin të tjerët shqetësohen.	Njerëz të tjerë i kanë sytë tek unë.
Njerëzit e tjerë:	Njerëzit e tjerë:	Njerëzit e tjerë:
Më shohin <ul style="list-style-type: none"> ▶▶ Përqendrojnë vëmendjen tek unë. ▶▶ Më njohin. ▶▶ Tregojnë familjaritet me mua. ▶▶ Ma mbajnë mend emrin. ▶▶ Janë të vëmendshëm ndaj pranisë sime. 	Më dëgjojnë <ul style="list-style-type: none"> ▶▶ Investojnë burime tek unë. ▶▶ Nxisin mirëqenien time. ▶▶ I kushtojnë vëmendje nevojave të mia. ▶▶ Më japin mbështetje emocionale. ▶▶ Ndjehen krenarë për mua. ▶▶ Kujdesen për mua. 	Vlerësojnë kontributin tim <ul style="list-style-type: none"> ▶▶ Varen nga unë. ▶▶ Kërkojnë mbështetje nga unë. ▶▶ Më besojnë kur jam me ta.

Siç mund ta shohim në tabelën e mësipërme, elementët e ndjesisë se jemi të rëndësishëm për të tjerë janë relativisht të zakonshëm. Megjithatë, përdorimi i kësaj ndjesie si një prizëm për të kuptuar se si e konsiderojnë

2 Përshtatur nga: (Elliott et al., 2004, p. 343)

veten të rinjtë e marginalizuar në marrëdhëniet me të tjerët në përgjithësi dhe në komunitetin e tyre më të gjerë, mund të jetë i dobishëm. Përdorimi i muzikës si një mjet dëgjimi për angazhim dhe komunikim efikas me të rinjtë e marginalizuar, mund të ndihmojë në fillimin e atij procesi që do t'i bënte ata të ndihen se janë me rëndësi për shoqërinë. Kështu mund të përmirësojmë angazhimin e të rinjve në një numër më të madh aktivitetesh në komunitet.

Pyetjet e mëposhtme janë hartuar për të kuptuar se sa të rëndësishëm për të tjerët ndjehen se janë të rinjtë. Sa të rëndësishëm janë të rinjtë për të tjerët?

1. Sa shumë vëmendje i kushtojnë të tjerët atij/asaj?
2. Sa do t'i marrë malli ata nëse ai/ajo largohet?
3. Sa interes tregojnë të tjerët për atë që thotë ai/ajo?
4. Sa shumë varen njerëzit nga ai/ajo?

Rëndësia që një i riu/e reja mendon se ka për të tjerët varet nga përgjigjet që jepen për pyetjet e mësipërme, si më poshtë:

Aspak, Pak, Disi, Shumë


Mund të jenë tregues i rëndësisë që kanë për të tjerët.

Rrota e rëndësisë për të tjerët na ndihmon të kemi një pamje të mënyrës se si njerëzit krijojnë ndjesinë e rëndësisë që kanë për të tjerët në komunitetin e tyre. Të rinjtë kanë nevojë të ndjejnë se kanë vlerë për komunitetin dhe se kanë mundësi për t'i shtuar vlera atij komuniteti. Krijimi i ndjesisë se kanë rëndësi për të tjerët mund të jetë me rëndësi të veçantë për të rinjtë që kanë përjetuar përvoja negative në fëmijëri. Fëmijët që kanë një ndjesi të ngulitur se ata janë të parëndësishëm për familjen, shkollën dhe komunitetin janë më të prirur të tentojnë për të gjetur forma ku të evidentohen dhe të vihen në dukje, forma që nuk janë pjesë e normave, pra të pranueshme për shoqërinë. Hulumtimet në Britaninë e Madhe³ konstatojnë se për disa të rinj, përfshirja në sjellje kriminale dhe antisociale është një formë alternative që këta të rinj të ndjehen se janë të rëndësishëm dhe se kanë ndikim në botë.



3 Billingham, L., dhe Irwin-Rogers, K. (2021) 'Humnera e tmerrshme e parëndësishëm: marginalizimi, ndjesia e të qenit i rëndësishëm dhe dhuna mes të rinjve'. Onati Socio-Legal Series 11(5)





Rrota e rëndësisë që kanë për të tjerë⁴

Në hulumtimin tonë me meshkujt në konflikt me ligjin në Shqipëri, konstatuam se shumë pjesëmarrës diskutuan për dëshirën për të “të qenë dikushi” dhe/ose “të bëhen dikushi” në të ardhmen. Këtë e kemi lidhur me konceptin e të qenit me rëndësi për dikë; që të rinjtë e marginalizuar dëshirojnë të kenë rëndësi për komunitetin dhe shoqërinë e tyre.

4 (Prilleltensky, 2020, p. 21)

2. SI ËSHTË PRITUR RRËFIMI MUZIKOR NË KONTEKSTIN SHQIPTAR?



“Kisha nevojë për të...është çliruese” (intervista 3 në komunitet)

Para trajnimit përmes rrëfimit muzikor, kemi pilotuar përdorimin e kësaj metode në hulumtimet sociale në Shqipëri me të rinj në konflikt me ligjin. Plot 20 të rinj që ishin nën mbikëqyrjen e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri morën pjesë në pilotimin e rrëfimit muzikor. U përfshinë pjesëmarrës nga tre institucione të vuajtjes së dënimit, nga shërbimi i provës në komunitet dhe nga shërbimi i trajtimit për abuzimin me substancat.

Puna në terren për rrëfimin muzikor u zhvillua në dy faza të veçanta. E para ishte një studim pilot i kryer në **tre institucione të ndryshme të vuajtjes së dënimit në Shqipëri**. Gjatë zbatimit të kësaj faze, u përballëm me sfida të konsiderueshme mjedisore dhe logjistike brenda mjedisëve të burgut gjatë punës në terren, të cilat sollën si rezultat që intervistat në grup të kryheshin duke përdorur muzikë. Kjo solli disa përshtatje të metodës në terren, por krijoi edhe potencialin e përdorimit të rrëfimit muzikor në një situatë grupi. Faza e dytë e punës në terren lidhej me një **studim për rrëfimin muzikor në komunitetin** me meshkuj që kanë qenë të angazhuar në sistemin e drejtësisë penale, disa nëpërmjet shërbimit të provës dhe disa nëpërmjet një shërbimi vendor për trajtimin e abuzimit me substanca.

Në këtë hulumtim konstatuam se rrëfimi muzikor ishte një metodë efikase për t'u përfshirë dhe për të dëgjuar historitë e jetës së të rinjve të marginalizuar. Muzika krijoi një urë mirëkuptimi dhe u mundësoi të rinjve të tregonin për përvojat negative të fëmijërisë që kishin ndikuar tek ta si dhe për përvojat e tyre në sistemin arsimor e të drejtësisë penale.

Përdorimi i rrëfimit muzikor është një përvojë e re në kontekstin shqiptar. Rrëfimi ka qenë një risi e paprovuar më parë dhe gjetjet që evidentuam tregojnë se ishte një mjet efikas për të nxitur përfshirje, për të krijuar besim në një hapësirë të shkurtër kohore dhe për t'i mbështetur pjesëmarrësit kur tregojnë historitë nga jeta e tyre plot sfida e marginalizime. Intervistat me rrëfim muzikor i zhvendosën disbalancat tradicionale të pushtetit.



3. PËR KË VLEN KY UDHËZUES?


Ky manual është hartuar për t'u ardhur në ndihmë profesionistëve që punojnë me grupe e cenushme ose të marginalizuar për të përdorur rrëfimin muzikor në punën e tyre. Rrëfimi muzikor është një mjet dëgjimi që mund të mbështesë angazhimin pozitiv me të rinjtë.

Në trajnim dhe në këtë udhëzues profesionistët do të udhëzohen hap pas hapi se si ta përdorin rrëfimin muzikor si një mjet alternativ për komunikim me të rinjtë vulnerabël dhe për të bërë të mundur angazhim efikas të tyre si individë.

Përdorimi i muzikës si mjet dëgjimi nuk e dëmton procesin dhe i jep mundësinë përdoruesit të shërbimit të flasë për jetën e tij në mënyrën e vet. Për këtë arsye, ajo konsiderohet një mënyrë me rrezik relativisht të ulët për t'u angazhuar me njerëzit e marginalizuar. Një nga përfitimet kryesore është krijimi i një ure mirëkuptimi me të rinjtë, duke u ofruar atyre mundësinë të zgjedhin shijen dhe zhanrin e muzikës që kanë dëshirë të dëgjojnë dhe të përdorin aspekte të ndryshme të këngës (tekste, kolona zanore, videoklipe muzikore, etj.). Nëpërmjet krijimit të një hapësire të çlirët ku dëgjojmë të rinjtë teksa përdorin muzikën, rriten mundësitë për të identifikuar përvojat e ndryshme negative të fëmijërisë me të cilat ata janë përballur. Duke u angazhuar për t'i dëgjuar ata me vëmendje, mendojmë se kjo metodologji do të përmirësojë ndjenjën e 'të qenit i rëndësishëm' tek të rinjtë në komunitetet e tyre.



4. NGA T'IA FILLOJMË ME RRËFIMIN MUZIKOR?





Hapi 1

Krijimi i një mjedisi mirëbesimi

HAPI 1: KRIJIMI I NJË MJEDISI MIRËBESIMI

Ndiqni udhëzimet për mbrojtjen e fëmijëve

Të gjithë ata që punojnë me fëmijët kanë përgjegjësi për t'i mbajtur ata të sigurt si dhe duhet të dijnë si të raportojnë shqetësimet që konstatojnë në lidhje me abuzimin fizik, emocional ose seksual; neglizhencën; trafikimin ose shfrytëzimin, në mënyrë që këto shqetësime të mund të trajtohen shpejt dhe në mënyrën e duhur.

Fëmijët dhe të rinjtë që përballen me profesionistë duhet të mbrohen sa më mirë që të jetë e mundur nga veprimet dhe dështimet e qëllimshme apo të paqëllimshme që i vendosin ata në rrezik abuzimi, shfrytëzimi seksual ose kriminal, në rrezik dëmtimi si dhe nga çdo dëm tjetër ndaj tyre.

Çfarë kuptojmë me mbrojtjen?

Mbrojtja është veprimi që ndërmerret për të promovuar mirëqenien e fëmijëve dhe për t'i ruajtur dhe mbajtur larg ata nga dëmtimi. Ruajtje do të thotë mbrojtje e fëmijëve nga abuzimi dhe keqtrajtimi, parandalimi i dëmtimit të shëndetit ose i zhvillimit të fëmijëve, siguria që fëmijët të rriten duke u ofruar kujdesin e duhur dhe efikas.

Keqtrajtimi. Dëmtimi i shëndetit fizik ose mendor (përfshirë atë që ka vuajtur duke parë ose dëgjuar një person tjetër që është bërë objekt keqtrajtimi).

Abuzimi me fëmijët klasifikohet në kategoritë e mëposhtme:

- ▶▶ Bulizmi dhe bulizmi kibernetik (online)
- ▶▶ Shfrytëzimi seksual i fëmijëve
- ▶▶ Trafikimi i fëmijëve
- ▶▶ Shfrytëzimi dhe bandat kriminale
- ▶▶ Abuzimi në familje
- ▶▶ Abuzimi emocional
- ▶▶ Gjymtimi i organeve gjinitale femërore

- ▶▶ Përgatitja për shfrytëzim seksual
- ▶▶ Neglizhenca
- ▶▶ Abuzimi i hershëm
- ▶▶ Abuzimi online
- ▶▶ Abuzimi fizik
- ▶▶ Abuzimi seksual

Si të përgjigjemi kur një fëmijë na tregon për abuzimet ndaj tij/saj?

- ▶▶ Dëgjoje me qetësi dhe vëmendje.
- ▶▶ Lëre të kujtojë lirisht atë që është e rëndësishme për të.
- ▶▶ Mos i jep përshtypjen që nuk e beson. Thelbi i problemit nuk është nëse ti e beson apo jo.
- ▶▶ Pasi të kesh vendosur për ta raportuar situatën, mos bëj pyetje të tjera. Që nga ky moment, situatën e marrin në dorë profesionistët.
- ▶▶ Mbjaj shënime mbi diskutimin, vendin dhe kohën kur ndodhi, mbi atë që tha fëmija dhe se cilët persona ishin të pranishëm.
- ▶▶ Ki parasysh se mund të jesh personi i parë tek i cili fëmija është hapur. Merre seriozisht çështjet e raportimit të situatës sado e pabesueshme që mund të të duket ajo.

! Ruani konfidencialitetin dhe kuni kujdes me informacionin që ndani me të tjerë.

Shkëmbimi i informacionit dhe raportimi i shkeljeve u mundëson profesionistëve dhe agjencive të identifikojnë dhe ofrojnë shërbimet e duhura që mbrojnë dhe promovojnë mirëqenien e fëmijëve. Më poshtë renditen mitet e zakonshme që mund të pengojnë ndarjen e informacionit në mënyrë sa më efikase.

A është pengesë legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave për ndarjen e informacionit?

Jo! Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave 2018 dhe Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave hartuar sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008,



“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, përcaktojnë se mbledhja dhe shpërndarja e informacionit personal nuk janë të ndaluara, por ligji përcakton një kuadër për të siguruar që informacioni personal ndahet në mënyrën dhe format e duhura. Në mënyrë të veçantë, ky ligj balancon të drejtat e subjektit të informacionit (individit për të cilin bën fjalë informacioni) dhe nevojën e mundshme për të shkëmbyer informacion .

Nevojitet pëlqimi për të ndarë informacionin personal?

Jo! Nuk keni nevojë të merrni pëlqimin paraprak për të ndarë informacionet personale. Respektimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave varet nga ju, por nuk është e vetmja mënyrë. Nuk është e nevojshme të kërkohet pëlqimi për ndarjen e informacionit për qëllime të sigurimit dhe promovimit të mirëqenies së një fëmije nëse ekziston një bazë e ligjshme për të përpunuar çdo informacion personal të kërkuar. Mbrojtja dhe parandalimi i dëmit janë arsye të ligjshme për të ndarë informacionin në mënyrën e duhur.

A mund t'i bëhen të ditura informacionet personale të mbledhura nga një organizatë/agjenci një agjencie tjetër?

Jo! Nuk është ky rasti, vetëm në rast se informacioni do të përdoret për qëllime që nuk përputhen me qëllimet për të cilat u mbledh ky informacion. Në rastin e fëmijëve në nevojë apo të fëmijëve në rrezik dëmtimi serioz, është e vështirë të parashikohen rrethanat ku ligji për mbrojtjen e të dhënave do të bëhej pengesë për ndarjen e informacionit personal me profesionistët.

A e pengon ndarjen e informacionit detyra për ruajtjen e konfidencialitetit dhe ligji për mbrojtjen e të drejtave të njeriut i vitit 1998?

Jo! Ky nuk është rasti. Përveç Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave, profesionistët duhet të gjejnë balancën mes detyrës ligjore për ruajtjen e konfidencialitetit dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut të vitit 1998 ndaj efektit që mund të shkaktohet tek individët apo tek të tjerët për shkak të mosndarjes së informacionit. Bëjini këtë pyetje vetes: “Çfarë mund të ndodhë nëse nuk i tregoj dikujt?”.



Si t'jua shpjegojmë konfidencialitetin fëmijëve?

“Vendi ku punoj ofron shërbime konfidenciale. Kjo do të thotë që, zakonisht, gjithçka që dëshiron të mbahet e fshehtë do të mbetet e fshehtë, por ndonjëherë, do të më duhet që disa informacione t'ua tregoj edhe të tjerëve me qëllim që të të ndihmojnë. Herë pas here mund të më duhet ta ‘shkel konfidencialitetin’ dhe t’i tregoj dikujt, pra, t’i tregoj dikujt në një pozicion me pushtet dhe autoritet. Kjo është shumë e rrallë. Por më duhet ta bëj këtë vetëm kur mendoj që dikush është në rrezik dhe ka nevojë për ndihmë. Këto gjëra do t’ua tregoj vetëm njerëzve që është e nevojshme ta dinë dhe askujt tjetër.”





Hapi2

Përgatituni për fazën e intervistës

HAPI 2: PËRGATITUNI PËR FAZËN E INTERVISTËS

1. Përgatisni fletën përmbledhëse për pjesëmarrësin dhe formularin e pëlqimit

Është me rëndësi që pjesëmarrësit të jenë të informuar për të drejtën e tyre për t'u tërhequr nga hulumtimi si dhe për hollësi të tjera, si konfidencialiteti dhe anonimat i të dhënave.

2. Udhëzoni pjesëmarrësin për shërbimet mbështetëse

Pjesëmarrja në hulumtime për tema të ndjeshme mund t'ju sjellë pjesëmarrësve kujtime të dhimbshme e të hidhura. Është me rëndësi që hulumtuesi të udhëzojë e informojë pjesëmarrësit për shërbimet e nevojshme mbështetëse në dispozicion, p.sh., këshillimi dhe mbështetja morale (aty ku ka mundësi dhe kur kjo gjë është e nevojshme).

3. Regjistroni intervistën duke përdorur një pajisje regjistrimi

Përdorni një pajisje regjistrimi, si diktofon, për të regjistruar intervistën, vetëm pasi pjesëmarrësi të ketë dhënë pëlqimin e plotë.

4. Luani muzikë

Merrni me vete një pajisje në dhomën e intervistës ku të luani muzikë. Pajisje të tilla mund të jenë kompjuter portativ (laptop) me lidhje me internet në Youtube (ku mund të luhen videoklipe muzikore) ose këngë të zgjedhura të regjistruara në laptop.

Personi në moshë të re që do të intervistohet duhet të jetë në gjendje të vendosë muzikën që zgjedh të luajë. Ky person duhet të ketë kontrollin e këtij aspekti të seancës.

5. Mbaj shënime në intervistë dhe mbani një ditar me përshtypje

Në mënyrë që hulumtuesi të marrë parasysh reflektimet e veta mbi



dinamikën e intervistës, rekomandohet që të mbahen shënime për reflektimet tuaja personale nga intervistat.

1. Nëse muzika krijon një urë mes jush dhe të intervistuarit, duhet të reflektojme edhe për përgjigjet tona.
2. Mund të jetë frytëdhënëse të mbahet një ditar ku të bëhen shënimet:
 - a. *A më sollli kujtime/probleme muzika/intervista?*
 - b. *Cilat ishin supozimet/stereotipet kur dëgjova këngët/rrëfimin?*
 - c. *Si ndjehem kur dëgjoj më vëmendje dhe i angazhuar?*
 - d. *Kujdesi për vetveten. Rrëfimi muzikor është një mjet i fuqishëm kur punon me çështje të ndjeshme. Ndaj, kini parasysh se duhet të kujdeseni edhe për veten kur dëgjoni rrëfime të dhimbshme.*



Para se të nisni me fazën e intervistës kini parasysh:

1. Bëni një planifikim paraprak për pjesëmarrësit

- 1 Jepuni pjesëmarrësve të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me temën e hulumtimit, siç detajohet në fletën informuese dhe në formularin e pëlqimit.

Ky informacion ua bën të mundur të shohin se i plotësojnë kriteret e hulumtimit dhe të kuptojnë historitë për të cilat tregojnë interes hulumtuesit. Kjo do të shmangë nevojën për pyetje të drejtpërdrejta në intervistë.

- 2 Bëjani të mundur pjesëmarrësve të marrin në konsideratë dëshirat e tyre muzikore para fillimit të takimit me ta. Duke menduar që në fillim për muzikën që do të dëgjojë, pjesëmarrësi përgatitet për të pasur mundësinë të planifikojë paraprakisht kontributin që do të japë në forma të ndryshme, duke zgjedhur muzikën dhe duke vendosur se kur do ta luajë atë gjatë intervistës.



2. Lëreni pjesëmarrësin të luajë muzikë kur të ketë dëshirë

Kjo i bën të mundur pjesëmarrësve të drejtojnë hapësirën e intervistës dhe i vë ata në një rol më të rëndësishëm se në intervistat tradicionale të strukturuar.

3. Më pak sjell më shumë: më pak pyetje dhe më shumë dëgjim

Si hulumtues, duhet të përdorni dëgjimin aktiv dhe të vëmendshëm dhe t'u krijoni mundësi pjesëmarrësve të vendosin vetë se çfarë duan të ndajnë me ju. Intervistat e rrëfimit muzikor përcaktohen nga përdorimi i muzikës si mjet dhe jo nga pyetjet e paracaktuara.

Intervistat me rrëfim muzikor mund të duken plot gjallëri.

Heshtjet dhe dëgjimi bashkërisht i muzikës mund të duket paksa i sikletshëm në fillim.

Por hapësira mes pauzave të qetësisë mund të ofrojë mundësi për rrëfime autentike dhe të fuqishme.

Kini parasysh:

Nëse ka heshtje, mos bëni zhurmuesin.

Intervistat më të mira me rrëfim muzikor NUK kanë pyetje nga intervistuesi.

Kjo mund të jetë e sikletshme për disa të intervistuar, pasi nuk kanë pasur mundësinë dhe hapësirat për t'u dëgjuar nga të tjerët.

Kujtoni 'ndjesinë e të qenit i rëndësishëm' – po u japim hapësirë njerëzve për t'u dëgjuar, duke u treguar atyre me vepra se ata kanë rëndësi për ne.



Vetëm dëgjoni.

Elementi më i ndërlikuar i kësaj situatë është thjeshtësia e tij.

Thjesht dëgjoni.



4. Krijoni mundësinë që pjesëmarrësit të reflektojnë

Aty ku është e mundur, është praktika më e mirë t'u bëhet e mundur të intervistuarve të shohin zbardhjen e asaj që kanë thënë dhe mundësinë për një seancë të shkurtër përmbledhëse dhe/ose intervistë të dytë.

5. Praktikoni intervista të pastrukturuara

Krijimi i një hapësire të sinqertë interviste është i rëndësishëm për të bërë të mundur funksionimin e metodës së rrëfimit muzikor. Mos merrni pyetje të përgatitura paraprakisht dhe, në vend të kësaj, lëroni pjesëmarrësin në moshë të re të ndajë sa më shumë ose aq pak sa ka dëshirë ai. Në përvojën tonë me këtë metodë, kjo do të bëjë të mundur që pjesëmarrësit të ndajnë më shumë informacione dhe histori personale në fund.



Hapi3

Zgjidhni një temë për seancat e intervistës

HAPI 3: ZGJIDHNI NJË TEMË PËR SEANCAT E INTERVISTËS

1. Stimujt në seancat individuale

Gjatë ndërtimit të një pyetjeje për muzikën që do të zgjedhë pjesëmarrësi, është me rëndësi që ta bëni veten të dukeni si një dëgjues i thjeshtë dhe **pjesëmarrësin si ekspert**. Ja disa shembuj të temave të gjera që mund të përdoren në intervistat me rrëfim muzikor.

Shembull:

Zgjidh tre këngë që të ndihmojnë të më tregosh pjesë nga historia e jetës tënde:

- ▶ Mund ta lësh këtë opion të hapur për interpretime nga pjesëmarrësi;
- ▶ Fëmijëria, vitet e adoleshencës së hershme dhe ditët e sotme;
- ▶ Para ngjarjes (arrestimit, p.sh.) gjatë dhe më pas;
- ▶ Para, gjatë dhe pas përjashtimit nga shkolla;
- ▶ Para, gjatë dhe pas emigrimit në një shtet tjetër.

Zgjidh një këngë që:

- ▶ Të ndihmon të më tregosh si u ndjeve në atë ditë të caktuar;
- ▶ Më ndihmon të kuptoj shpresat që ke për të ardhmen;
- ▶ Më ndihmon të kuptoj si u ndjeve për incidentin;
- ▶ Më ndihmon të kuptoj se ç'do të thotë të jesh djalë/vajzë në Shqipëri;
- ▶ Më ndihmon të kuptoj se çfarë është shkolla për ty.

Hapësira për të mbajtur shënim idetë për vetë kontekstin tuaj



2. Seancat në grup – Ofrimi i një seance në grup duke përdorur një këngë

Kur ndërtoni pyetje në grup, duhet të siguroheni që të kërkonit diçka që është mjaft e gjerë me qëllim që pjesëmarrësit të mos ndihen të detyruar të ndajnë më shumë nga sa kanë dëshirë.

Në seancat në grupe, temat duhet të jenë më të gjera dhe më të hapura për diskutim, në mënyrë që të gjithë të përfshihen në diskutime pa pasur nevojë të tregojnë çështje që janë të ndjeshme për ta.

Shembuj:

Kërkojini çdo pjesëmarrësi të kërkojë një këngë/videoklip që e ndihmon të bëjnë komente për një temë të gjerë:

- ▶ Të jesh në moshë të re në Shqipëri;
- ▶ Të jesh anëtar i një komuniteti të madh;
- ▶ Të jesh nxënës në shkollën e qytetit të lindjes.

Kërkojini çdo pjesëmarrësi të kërkojë një këngë ku shprehen ndjenjat e tij/saj më lidhje me:

Jetën e tij/saj;

Komunitetin e tij/saj;

- ▶ Aspiratat (shpresat dhe ëndrrat);
- ▶ Pengesat ose betejat.

Hapësira për të mbajtur shënim idetë për vetë kontekstin tuaj



3. Seanca në grup – Trajnimi i të rinjve për të përdorur rrëfimin muzikor

Mund të kalohet nga përdorimi i muzikës drejtpërsëdrejti me të rinjtë si pjesëmarrës, në opsionin e trajnimit dhe inkurajimit të tyre për ta përdorur vetë këtë teknikë.

Intervista me të rinj

Kërkojuni të rinjve të identifikojnë njerëz në komunitetin e tyre, të cilët duan t'i intervistojnë duke përdorur muzikën. Këta njerëz mund të jenë:

- ▶▶ Të moshuar në komunitet;
- ▶▶ Figura të njohura në vend;
- ▶▶ Drejtues vendorë;
- ▶▶ Profesionistë në role të ndryshme.

Më pas, grupi i të rinjve mund ta hartojë vetë intervistën dhe t'u kërkojë të intervistuarve të thonë se cilat këngë iu pëlqejnë dhe të tregojnë historitë e jetës. Kjo mund të regjistrohet për një podcast ose video dhe të hidhet në internet.

Edhe kjo mund të jetë reciproke. Të rinjtë mund të luajnë një pjesë muzikore për një temë (si p.sh. komuniteti) dhe t'u kërkojnë drejtuesve vendorë që më pas të zgjedhin ata këngën e tyre. Ky mund të ketë potencialin për të qenë një shkëmbim mjaft i dobishëm që promovon mirëkuptimin dhe angazhimin ndërmjet brezave.

Kështu krijohet mundësia që të rinjtë të zgjedhin një temë me interes për komunitetin e tyre, siç është politika, ose rigjallërimi apo zhvillimi vendor.

Hapësira për të mbajtur shënime idetë për vetë kontekstin tuaj

